




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA PROTIV KORRUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Bi Prot. <u>01-196/14</u>
Nr. l faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>22-01-2014</u>
Nr. pages	Date



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 20.01.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllët rasti më nr. AKK-03-3261\13, për zyrtarin e lartë znj. Shefkije Mehmeti, Kryesues në Kuvendin Komunal të Novobërdës, për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej pasi që ka bërë shuarjen vullnetare të biznesit privat të saj.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës së marrë ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK-03-3261/13, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë, znj. Shefkije Mehmeti, Kryesues në Kuvendin Komunal të Novobërdës.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si, Kryesues në Kuvendin Komunal të Novobërdës, është duke ushtruar edhe një funksion në biznesin e saj private "N.T.P EDI", e që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 21.10.2013, e ka njoftuar zyrtaren e lartë

me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, znj. Shefkije Mehmeti, Kryesues në Kuvendin Komunal të Novobërdës, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë, ka kërkuar që ti behët një sqarim lidhur me situatën e dyshuar për konflikt të mundshëm të interesit.

Zyrtarët e Agjencisë gjatë takimit që kanë mbajtur me zyrtarën në fjalë e kanë njoftuar me faktet që posedon Agjencia, lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit, në ushtrim të funksionit publik, zyrtari në fjalë pasi që ka marrë edhe informatat në mënyrë verbale, është pajtuar për situatën në të cilën ndodhet dhe është zotuar se do të bëjë ndryshimet në biznes dhe do të bëjë hapa për ta mbyll biznesin pasi që ai nuk është funksional.

Zyrtari i lartë, znj. Shefkije Mehmeti, Kryesues e Kuvendin Komunal të Novobërdës, pas kësaj ka sjellë dëshmitë e lëshuara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, ku dëshmon se në mënyrë vullnetare ka bërë shuarjen, asgjësimin vullnetare të biznesit privat me emër "N.T.P EDI".

Andaj konsiderojmë se zyrtari i lartë znj. Shefkije Mehmeti, Kryesues në Kuvendin Komunal të Novobërdës, ka shmangur gjendjen e mundshme të Konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtori Agjencisë kundër Korrupsionit

